



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:009211
Datë: 27.12.2023
Numri i dokumentit: 05125539

Ep.nr.32/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Blerta Kelmendi, në çështjen juridike-përmbartimore të kreditorit K “A”, Sh.A, rruga “Xh. S”, F. e P , rruga e T, p.n, në Pejë, ndaj debitorit Rr. S. S, me adresë në rrugën “Gj. Sh”, p.n, në Pejë, me bazë juridike përmbartimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e datës 14.12.2021 të paraqitur nga personi i panjohur, kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr./I.Br.1558/19, të datës 31.10.2019, të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, jashtë seancës gjyqësore, me 27.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si i palejuar prapësimi i paraqitur nga personi i panjohur, kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr./I.Br.1558/19, të datës 31.10.2019, të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë.
- II. ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr./I.Br.1558/19, i datës 31.10.2019, i Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, si dhe të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra në këtë procedurë, si të palejueshme.

A r s y e t i m

Kreditori K “A”, Sh.A, ka parashtruar propozim për lejjimin e përmbartimit tek Përmbartuesi Privat, ndaj debitorit “R” S. S, në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve të ujësjellësit në shumën prej 611.86 Euro.

Përmbaresi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit ka caktuar Urdhrin për Përmbarim P.nr./I.Br.1558/19, të datës 31.10.2019.

Me datën 14.12.2021, kundër këtij urdhri përmbarimor, në emër të debitorit është paraqitur prapësim nga personi i panjohur, i cili i ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes së debitorit S. S.

Në prapsim theksohet se debitori e kundërshton këtë propozim për përmbarim pasi që i njëjti urdhër për përmbarim është marrë në shkelje të dispozitave nga neni 71 par.1 pika 1.1 dhe 1.4 të LPP-së, ngase dokumenti i besueshëm- ekstrakti i verifikuar nuk është në origjinal apo kopje të vërtetuar dhe e ngarkon debitorin në mënyrë paushall, ku në të njëjtën kohë debitorit nuk ju është ekspeduar dhe dorëzuar personalisht asnjëherë faturat mujore lidhur me shfrytëzimin e shërbimeve të ambientit, e që për të njëjtin nuk prezantojnë asnjë fature që kishte për të vërtetuar këtë borxh. Gjithashtu bazuar në dispozitën e nenit 360 par.1. pika 1.3 dhe par.2 të LMD-së, kërkesa është parashkruar dhe nuk mund të kërkohej përmbarimi duke i propozuar gjykatës që të pranohet prapësim, të prishet urdhri përmbarimor dhe të përfundohet procedura.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pasi ka vlerësuar shkresat e lëndës, gjen se prapësimi i paraqitur në emër të debitorit nga personi i panjohur, duhet të hedhet poshtë si i palejuar, pasi që i njëjti nuk është palë në këtë procedurë përmbarimore dhe nuk ka dëshmuar se është i autorizuar për të përfaqësuar interesat e debitorit.

Gjykata në mbështetje të nenit 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), i cili përcakton se: *“Në procedurën përmbarimore përshtatshëmish zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*, si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë, ka zbatuar nenin 76 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), ku parashihet që: *“Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm”*, ka konstatuar se personi që ka paraqitur prapësimin nuk është palë debitore në këtë lëndë përmbarimore dhe i njëjti përkundër faktit që

në prapsim është nënshkruar për debitorin nuk ka sjellë ndonjë provë që do të dëshmonte se është i autorizuar për të përfaqësuar interesat e palës debitore.

Sipas nenit 78 par.1 të LPK-së, përcaktohet se: *“Kur gjykata konstaton se personi që paraqitet si palë nuk mund të jetë palë në procedurë, dhe se kjo mungesë mund të evitohet, do ta ftojë paditësin që të bëjë ndreqje të nevojshme në padinë ose do të ndërmarë masa të tjera me qëllim që procedura të mund të vazhdohet me personin që mund të jetë palë në procedurë”.*

Mirëpo, pasi që gjykata i ka vlerësuar shkresat e lëndës ka rezultuar se pala debitore, në rastin konkret S. S, ka vdekur, konsideron se të metat nuk mund të mënjanohej, pasi që procedura përmbartimore është iniciuar nga kreditori ndaj debitorit i cili ka vdekur me datën 04.01.2016 (sipas certifikatës së vdekjes me numër serik: V, me numër rendor, me datë të lëshimit, nga Zyra e Gjendjes Civile në Pejë), më shumë se 3 vite para inicimit të procedurës përmbartimore kundër tij me propozimin për përmbartim të datës 31.10.2019.

Kësisoj, pasi që gjykata nuk ka mundur të kërkoj nga kreditori që të evitohet të metat në lidhje me legjitimitetin real pasiv të palës debitore, ngase një e metë e tillë nuk ka mundur të mënjanohet për faktin se debitori S.S, ka vdekur para inicimit të procedurës dhe për këtë nuk ka mundur të ketë cilësinë e palës në këtë procedurë përmbartimore, si dhe në zbatim të paragrafit 4 të nenit 78 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se të metat e treguara nuk mund të mënjanohej, apo në qoftë se afati i caktuar nga gjykata kalon pa sukses, gjykata me aktvendim i abrogon veprimet e kryera po që se janë përfshirë me të metat në fjalë dhe do ta hedhë poshtë padinë, po që se të metat kanë natyrë të tillë që pengojnë procedimin e mëtutjeshëm të çështjes”*, ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr./I.Br.1558/19, të datës 31.10.2019, të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, si dhe të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra në këtë procedurë, si të palejueshme, pasi që procedura përmbartimore nuk mund të fillohet, zhvillohet dhe përfundoj ndaj një personi i cili nuk ka subjektivitet, gjegjësisht zotësi juridike.

Për më tepër në rastin konkret, nuk ka mundur të gjejë zbatim dispozita e nenit 35 par.4 të LPP-së, pasi që është konstatuar fakti se debitori ka vdekur më shumë se 3 vite para se ndaj tij kreditori të parashtrij propozimin për përmbartim. Në këtë drejtim, neni 35 par.4 i LPP përcakton se: *“Në rast të vdekjes së debitorit që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë, Gjykata, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita në të cilën është njoftuar për vdekjen e debitorit, emëron*

përfaqësuesin e përkohshëm në emër të trashëguesve të debitorit në ngarkim të shpenzimeve të kreditorit, si rregull nga radha e personave që e kanë në posedim pasurinë që është objekt përmbarimi, dhe vazhdon procedurën. Gjykata e emëron përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës”. Kjo dispozitë ligjore zbatohet në të gjitha rastet kur debitori vdes pas fillimit të procedurës përmbarimore, e jo para fillimit të saj kësisoj marrja e të drejtave në rastin konkret nga pasardhësit në rastin e vdekjes së debitorit është i palejueshëm për arsyet e lartcekura.

Nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 17 të LPP-së, lidhur me nenin 78 par.1 dhe 4 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2022:009211
Ep.nr.32/2022, me datën 27.12.2023.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes Gjykatës
Themelore në Pejë.